



BASHKIA E TIRANËS
NJËSIA ADMINISTRATIVE VAQARR

Adresa: Rr "Kavajës" km 6, Vaqarr Tirane , e-mail: nj.adm.vaqarr@gmail.com

Vaqarr, më ____ . ____ . 2017

Proçes verbal

Sot, në datë 24.11.2017 u mbajt dëgjese publike në ambjentet e Njesisë Administrative Vaqarr me tematik "**Buxheti për vitin 2018**" Për Njësine Administrative Vaqarr, Bashkia Tiranë. Në këtë takim ishin të pranishëm : Administratori i Njesisë Administrative Vaqarr **Z. Gentian Myrta, Z. Erind Bejko** Drejtor në Drejtorinë e Objekteve në Bashkëpronësi, Koordinimi i Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile.

Të pranishëm të tjerë ishin ndërlidhësit me komunitetin, banorë, punonjësit e Njesisë Administrative Vaqarr .

Programi i këtij takimi:

Z. Gentina Myrta Administratori i NJA. Vaqarrit pas falenderoj të gjithë pjesëmarrësit : i la fjalën ;

Z. Erind BEJKO, Drejtornë Drejtorinë e Objekteve në Bashkëpronësi, Koordinimi i Njësive Administrative dhe Emergjencat Civile .

Bashkë me falenderimet për pjesëmarrjen , Z. Bejko vuri në dukje që problemet janë të shumta por do meremi me gjëra të mëdha (Investime) për gjerat e vogla kemi Drejtoritë dhe Ndërrmarjet për nevoja dhe avari.

Kërkesat për vitin e ardhshëm janë:

Nga z.Bejko u përmendën këto investime për vitin 2018:

- Shkolla e Arbanës , rikonstrukcion .
- Fshatrat e Rilindjes urbane është zgjedhur Arbana në tërsi si fshatat për zhvillim dhe investim të përgjithshëm.

Diskutimet vazhduan në formë bashkëbisedimi rreth prioriteteve midis ndërlidhësve të komunitetit , banorëve dhe përfaqësuesve të Bashkisë Tiranë.

Qytetari I

Problemi i pastrimit .

Lagjia Dumje deri tek Shkolla Vishaj rruga është pa trotuar dhe përbën problem për fëmijët nga kalimi i makinave me tonazh te lartë.

Qytetari II

Problem tjetër në fshatin Vishaj është bileta e urbanit pasi nuk zbatohet nga linjat përkatës me cmimin real sipas VKB por vazhdojn të mbajnë cmimet që kanë patur.

Qytetari III

Kanalin Vaditës në fshatin Allgjatë, kanalizimet për mbajtjen e tokave bujqësore si dhe shkolla pa ujë dhe tualet.

Qytetari IV

Tek varrezat e Sharrës pas sistemimit të rrugës nacionale kanë mbetur dy rrugica të cilat përbëjn problem pasi shkarkojnë të gjithë ujrat e mbledhura në rrugën kryesore duke prishur investimin e ri që është bërë së fundmi, për këtë arsye këto dy rrugica kanë nevojë për ndërhyrje.

Mbledhja u mbyll me një falenderim për tëgjithë pjesëmarrësit!